



100 vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



VENDIM

Nr. 3 Datë 11 .01.2013

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TE PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT
TE ADMINISTRATORIT, NË ZBATIM TË VENDIMIN TE BORDIT
TE KOMISIONERËVE TE ERE NR. 158, DATE 16 NËNTOR 2012,
“PER FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCAVE PËR
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES DHE AKTIVITETIT TE
FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICE”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 13, të Rregullores për Procedurat e Heqjes se nje License, miratuar me vendimin nr. 68, datë 04.11.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Vendimit te Bordit te Komisionerëve te ERE nr. 158, date 16 nëntor 2012 “Per fillimin e procedurave per heqjen e licensave Shoqerise CEZ Shperndarje per aktivitetin e Shperndarjes dhe aktivitetit te Furnizimit Publik me Pakice”, neni 4 i Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2012, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e grupit te punes,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave te përzgjedhjes se administratorit potencial te shoqerise CEZ Shperndarje, emërimi i të cilit do bëhet efektiv ne rast te marrjes se Vendimit përfundimtar për heqjen e Licencës Shoqërisë se Interesuar, nga ana e Bordit te Kpmisionereve te ERE-s.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit të pergatisë gjithë procedurat në lidhje me zbatimin e këtij Vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI